

**GJYKATA E QARKUT NE MITROVICE**  
**P nr. 16/2009**  
**4 Gusht 2010**

**NE EMER TE POPULLIT**

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në Trupin Gjykses të përberë nga Gjyqtarët e EULEX-it; Agnieszka Klonowiecka-Milart si Kryetare e Trupit Gjykses, Charles L. Smith, III dhe Caroline Charpentier si Anëtarë të Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Noora Aarnio si Procesmbajtëse, në lëndën penale kundër

**RAMIZ ADEMI**, I akuzuar sipas aktakuzes së paraqitur me 19 Shkurt 2009 dhe e ndryshuar gojarisht në seancën e konfirmimit me 09 Shkurt 2010, me veprat penale **Tentim Vrasje** në kundërshtim me nenin 146 në lidhje me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe **Mbajtja në Pronësi, në Kontrollë, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armeve** në kundërshtim me nenin 328 Paragrafin (2) të KPPK.

Pas mbajtjes publike të gjykimit kryesor me 4 Gusht 2010, në prezencën e të akuzuarit Ramiz Ademi, avokatit të tij mbrojtës Rexhep Kaçaniku, Prokurori Publik i EULEX-it Neeta Amin dhe palës së dëmtuar Remzi Dibrani, pas këshillimit dhe votimit të Trupit Gjykses të mbajtur me 4 Gusht 2010, në të njëjtën ditë sipas nenit 392 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) publikisht dhe në praninë e të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës Rexhep Kaçaniku dhe Prokurores Publike të EULEX-it Neeta Amin, shpallë këtë

**AKTGJYKIM**

- I. I akuzuari **Ramiz Ademi**, pa pseudonim, i biri i Hajriz Ademi dhe Hanife Selimi, i lindur me 02 Maj 1978 në Fshatin Kozhice, Komuna e Skenderaj/Srbica, Kosovë-Shqiptar, me banim në fshatin Kozhice, me shkollë fillore, aktualisht i papunë, beqar, i padënuar me parë

**Shpallet Fajtor**



Sepse deri me 19 Janar 2009, në shtepine e tij në Kozhice, komuna e Skenderaj/Srbica, I akuzuari ka mbajtur në posedim dhe e ka përdorur një pistolette të tipit Browning, të kalibrit 7.65mm, me numer serik I-2401, me një karikator dhe katër fisheke të të njejtit kaliber, pa posedim të vlefshme të lejes për mbajtje të armëve.

Me një akt të tillë Ramiz Ademi ka kryer **vepren penale Mbajtja në Pronesi, në Kontrollë, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armeve** në kundërshtim me nenin 328 paragrafin (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK)

II. Prandaj, i akuzuari **Ramiz Ademi denohet me dy vite burgim.**

III. Duke u bazuar në Nenin 43 të KPK ekzekutimi i këtij denimi pezullohet **(suspendohet) për një periudhë verifikuese prej dy viteve.**

IV. Arma, Browning e kalibrit pistol 7.65mm me numer serik ca I-2401 me këtë rast konfiskohet nga Ramiz Ademi sipas nenit 60 paragrafi (1) dhe neni 328 paragrafi (5) i KPK.

V. I akuzuari Ramiz Ademi obligohet të mbulojë shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 102 paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthyesit dhe përkthimeve. Një aktvendim ndaras mbi shumën e shpenzimeve do të merret nga Gjykata kur të merren të dhënat e tilla sipas nenit 100 paragrafi (2) i KPPK.

VI. Akuza **Tentim Vrasje** nën nenin 146 lidhur me nenin 20 të KPK refuzohet duke u bazuar në nenin 389 të KPPK pas tërheqjes së akuzave nga Prokurori Publik.

## ARSYETIMI

Veprat penale të paraqitura me aktakuzë janë kryer me 19 Janar 2009, kohë kjo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri-emëruar të Kodit të Perkohshëm Penal të Kosovës dhe Kodit të Perkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (**Gazeta Zyrtare III/44**). Prandaj, Gjykata ka aplikuar numenklaturën e këtij ligji, është fjale për Kodin Penal të Kosovës (**KPK**) dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (**KPPK**).

Akuza **Tentim Vrasje** nën Nenin 146 lidhur me nenin 20 të KPK është tërhequr nga Prokurori Publik pasi që i vetmi dëshmitar, sa i përket kësaj akuze, ka



vendosur të mos japë dëshmi. Sipas Nenit 389 të KPPK, Gjykata ka qene e obliguar të refuzojë akuzen.

I akuzuari është deklaruar fajtor për akuzën **Mbajtja në Pronësi, në Kontrollë, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armeve.**

Gjykata është e bindur se materiali i mbledhur në dosjen e lëndes e mbështet mjaftueshëm akuzën sipas nenit 328 Paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës dhe i akuzuari e ka dhënë deklarinë e tij.

Në deklaratën që i pandehuri Ademi ia ka dhënë Zyres së Prokurorit më 2 shkurt 2009, ai ka pranuar se e ka pasur armën në posedim që nga viti 1998. Nga deklaratat rezultojnë se ai e ka mbajtur atë të gatshme për përdorim eventuale.


Dokumenti mbi konfiskimin e gjerave nr. 2009-BF-0083, të datës 19.1.2009 në emër të Pandehurit Ramiz Ademi dhe të nënshkruar nga vete i Pandehuri vërteton faktin se pistoletat e tipit "Browning" e kalibrit 7.65 mm me numër serik I-2401 dhe katër fisheke të kalibrit të njëjtë ishin iu ish-in konfiskuar atij.

Trupi Gjykoës ka konsideruar se një dënim me kusht do të shërbejë më së miri qëllimit të ndëshkimit sipas nenit 34 të KPK.

Sipas nenit 44 të KPK dënimi me kusht mund të shqiptohet kryesisht të vepres penale të dënuar me burg deri në 10 vite nëse aplikohen dispozitat lehtësuese të dënimit.

Sipas nenit 66 pika 2 e KPK, Gjykata mund të aplikojë lehtësimin kur vërteton se ka rrethana të veçanta lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet me shqiptimin e një dënimi me të lehtë.

Trupi Gjykoës e ka marrë si faktor lehtësues atë se e tërë ngjarja e përmbledhur në akuzat ka pasur një të kaluar të konfliktit familjar kur rolet e sulmuesit dhe të viktimës kanë qene të definuara përmes çështjeve dëshmuara në vend se të vërtetohet pa ndonjë dyshim. Ky konflikt ka përfunduar në kohën e seancës së konfirmimit. Të dyja palët vazhdimisht e kanë siguruar Gjykatën për pajtimin që kishte ndodhur ndërmjet tyre. Duke pasur parasysh këtë, shqiptimi i dënimit me burgim pa e pezulluar dënimin do të shkonte kundër qëllimit të dënimit për atë se do të, me gjithë gjasat, shihet si një përfundim i padrejtë dhe dëmtues për marrëdhënjet në atë familje.




Me tutje, Gjykata ka konsideruar se i akuzuari që nga fillimi i hetuesis ka treguar një keqardhje të vërtetë. Ai ka pranuar fajësinë e tij që nga fillimi i procedurave, Zyrtarëve të policis ia ka dorëzuar armën vullnetarisht dhe ka qenë kooperues në zbatimin e ligjit në dhënjen e dëshmisë. I akuzuari nuk ka dosje të mëparshme penale.

Gjykata vuri në dukje se sipas Ligjit mbi Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, zbutja e dënimit është parapare si një nga pasojat e Marreveshjes për deklarimin e fajësisë. Gjersa në këtë rast, teknikisht, nuk ka "Marreveshje mbi deklarimin e fajësisë", megjithatë Gjykata ka konsideruar se i akuzuari e ka ofruar deklarimin e tij të fajësisë menjehere dhe në mënyrë të vazhdueshme. Zbutja e dënimit në këto lende atehere do të ishte konsistente me praktiken aktuale penale të Kosovës, siq është reflektuar në Ligjin e lartshënuar.

Trupi Gjykoës e ka marrë si rrethanë rënduese posedimin e gjatë kohor të armës pa autorizim gjatë se cilës kohë i akuzuari nuk e ka përdorur dobine e amnesties dhe nuk ka tentuar të legalizojë armën. Trupi Gjykoës gjithashtu ka konsideruar se frekuenca e krimeve të kryera me përdorimin e armeve në Kosovë, si çështje e preventimit të përgjithshëm, thërret për sanksionimin me afat të konsiderueshëm me burg për posedim ilegal të armeve. Në anën tjetër, periudha me kusht prej dy viteve është e mjaftuar për të korrigjuar sjelljen e të akuzuarit dhe të ndalojë perseritjen e shkeljes së ligjit.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë  
P. nr. 16/2009

*E pregatitur në Anglisht, gjuhë e autorizuar*



Noora Aarnio  
Procesmbajtese

Agnieszka Klonowiecka-Milart  
Kryetare e Trupit Gjykses

Charles L. Smith, III  
Anetar i Trupit Gjykses

Caroline Charpentier  
Anetare e Trupit Gjykses

**Këshillë Ligjore.** Palët duhet të paralajmërojnë ankesën jo me vonë se 8 ditë pas shpalljes se aktgjykimit. Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesën me shkrim kunder këtij aktgjykimi para Gjykatës Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës brenda pesëmbëdhjetë ditëve (15) nga data e marrjes së kopjes së këtij aktgjykimit sipas nenit 398 paragrafi (1) i KPPK-së.

